

RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për miratimin e raportit mbi gjetjet kyçe të procesit të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit, materialit zgjedhor dhe pajisjeve të votimit dhe numërimit elektronik (PEVN), të përdorura në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 dhe për zgjedhjet për kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 shtator 2023”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

- **Stafi KQZ: Znj. M. Koja, z. E. Meta, znj. P. Doçaj.**

Parti Politike: S’ka prezent!


Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Mirëdita, atëherë në seancën e sotme publike, kemi në rendin e ditës këto çështje:

- Projektvendimin “Për miratimin e raportit mbi gjetjet kyçe të procesit të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit, materialit zgjedhor dhe pajisjeve të votimit dhe numërimit elektronik, të përdorura në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 dhe për zgjedhjet për kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 shtator 2023”. Kemi dhe dy,

- Projektvendime që lidhen me plotësimin e vakancave në këshillat e Bashkisë Durrës dhe Vau-Dejës.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 16.05.2024*

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me miratimin e raportit mbi gjetjet kyçe të verifikimit të procesit paszgjedhor për zgjedhjet e 14 majit 2023 dhe zgjedhjet e Bashkisë Kukës të datës 24 shtator 2023. Po Drejtor!


Z. E. Meta: Faleminderit! Neni 167/2 i Kodit Zgjedhor përcakton këqyrjen e mëpasshme të fletëve të votimit dhe të materialit zgjedhor, me qëllim verifikimin e rregullsisë dhe saktësisë së veprimtarisë së administratës zgjedhore përgjatë administrimit të procesit dhe vlerësimit të numërimit të votave. Në zbatim të sa më sipër, është miratuar vendimi nr. 800, datë 20.10.2023, “Për përcaktimin e procedurave të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore, për zgjedhjet e organeve të vetëqeverisjes vendore”. Përzgjedhja e qendrave të votimit ishte rastësore dhe u bë me short. Në listën e QV-ve për të cilat u hodh short nuk u përfshinë ato të këqyrura nga KAS gjatë procesit ankimor. Më 23 Tetor 2023, u hodh shorti dhe u përzgjedhën 526 qendra votimi nga 5208 qendra votimi të shortuara, që përfaqësojnë 10% të qendrave të votimit për çdo ZAZ. Rezultatet e shortit u miratuan nga Komisioneri me vendimin nr. 813, dhe procesi i këqyrjes paszgjedhore u zhvillua nga data 6 në 26 Nëntor 2023, ku u verifikuan të gjitha qendrat e votimit, përfaqësuese të 10% të totalit. Kjo këqyrje synoi të vlerësonte rregullsinë dhe saktësinë e veprimtarisë së administratës zgjedhore, duke përfshirë numërimin e votave dhe administrimin e procesit për çdo qendër votimi. Për Bashkinë Kukës, të njejtat qendra votimi të përzgjedhura iu nënshtruan verifikimit edhe për zgjedhjet për kryetarin e bashkisë të datës 24.9.2023. Për këqyrjen e fletëve të votimit dhe materialeve të votimit u ngritën tetë grupe për këqyrje, të cilët vlerësuan dhe plotësuan procesverbalet përkatëse për administrimin e informacionit. Të dhënat e pasqyruara në procesverbalet përkatëse të këqyrjes u përpunuan dhe u analizuan. Në kuadër të procesit të analizës së gjetjeve, u

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 16.05.2024*

konstatuan shkelje administrative. Në zbatim të nenit 77 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative, administrata e KQZ-së në vijim të procesit të hetimit administrativ, ka kontaktuar me personat e identifikuar si përgjegjës, qoftë të administratës zgjedhore në nivelin e anëtarit të komisionit të qendrave të votimit, apo anëtarit të grupit të numërimit të votave. Secilit prej personave, pjesë e administratës zgjedhore, iu komunikuan gjetjet nga procesi i këqyrjes dhe u kërkuan shpjegime/argumente nga ana e tyre. Në përfundim u ballafaquan të dhënat nga gjetjet e këqyrjes me shpjegimet e dhëna nga personat e identifikuar me shkelje dhe u përgatit ky raport. Projektraporti është organizuar në 4 krerë dhe trajton respektimin nga ana e komisioneve të qendrave të votimit të kërkesave procedurale gjatë procesit të votimit dhe të saktësisë së veprimeve të grupeve të numërimit të votave përgjatë procesit të vlerësimit dhe numërimit të votave. Kreu I përshkruan metodat e përdorura për administrimin e të dhënave dhe identifikimin e problematikave. Kreu II është i organizuar në 3 seksione dhe jep një paraqitje statistikore të pyetësorit lidhur me përmbushjen e detyrave ligjore dhe nënligjore nga administrata zgjedhore. Seksioni 1 i këtij kreu, trajton vendimmarrjet e komisioneve të qendrave të votimit dhe administrimin e tyre në dokumentacionin e punës. Në këtë seksion paraqiten të dhëna statistikore për administrimin e procesverbaleve dhe raporteve të hapjes dhe mbylljes së votimit, si dhe sfidat e identifikuara në administrimin e materialeve zgjedhore. Seksioni 2 fokusohet në administrimin e bazës materiale zgjedhore, duke përfshirë vulat e komisionit të qendrës së votimit dhe përdorimin e zarfeve specifike. Seksioni 3 jep të dhëna për saktësinë e veprimtarisë së grupeve të numërimit gjatë vlerësimit dhe numërimit të votave. Seksioni 4 pasqyron të dhëna statistikore lidhur me natyrën e pavlefshmërisë së votave të ndara sipas kategorive të përcaktuara në Kodin Zgjedhor. Kreu III pasqyron përvojën dhe rezultatet e pilotimit të pajisjeve elektronike të aplikuara në

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 16.05.2024*

zgjedhjet vendore dhe vlerëson efektivitetin e tyre në procesin zgjedhor. Në bashkitë ku u implementua votimi elektronik përputhej rezultati 100%. Kreu IV propozon masa specifike për adresimin e problematikave identifikuar gjatë procesit të votimit dhe numërimit të votave, duke përfshirë ndryshime ligjore, rishikime të procedurave dhe trajnime të administratës zgjedhore. Projektraporti u është dërguar për konsultim edhe partive politike dhe organizatave të shoqërisë civile. Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) ka paraqitur disa vërejtje dhe rekomandime lidhur me projekt raportin KRIIK rekomandon që KQZ të:

- Adresojë me vendosmëri dhe transparencë të plotë të gjitha gjetjet e procesit të auditimit duke dhënë sqarime lidhur me metodologjinë e përpunimit të të dhënave dhe përcaktimin e standardit si gabim njerëzor për devijimin e votave.
- Marrë masa administrative dhe bëjë kallëzim penal ndaj shkelësve, pa marrë parasysh përkatësinë politike.
- Përfshijë rekomandime të qarta dhe të detajuara në versionin final të Raportit të Auditimit.
- Bëjë një shqyrtim të plotë të rrethanave të pavlefshmërisë së votave, veçanërisht ato që janë bërë të pavlefshme nga mungesa e vulës prej njërit kryetarit/sekretarit të KQV-së.
- Ndërmarrë hapa për të mos përsëritur gabimet në proceset e ardhshme zgjedhore, duke përfshirë përmirësimin e trajnimeve për komisionerët e administratës zgjedhore. KRIIK thekson se standardet e vendosura nga KQZ për sanksionimin e komisionerëve në shkelje nuk duhet të zbehen, për të ruajtur integritetin e procesit zgjedhor dhe për të shmangur hapat në zbatim të ligjit. Administrata e KQZ-së ka vlerësuar, ka analizuar dhe ka shqyrtuar rekomandimet e KRIIK duke pasqyruar shpjegimet e nevojshme në raport, për të bërë më shumë transparencë lidhur me përmbajtjen e raportit dhe duke hartuar rekomandime të qarta dhe të detajuara për

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 16.05.2024*

adresimin e çështjeve të identifikuara gjatë këqyrjes paszgjedhore. Për sa më lart relatova, keni bashkëlidhur raportin e gjetjeve dhe projektvendimin për miratim.

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit Erjon! Nga ajo çfarë është pasqyruar në këtë raport të paktën në një vështrim paraprak të këtyre gjetjeve, duket që kemi një përmirësim të performancës së anëtarëve të komisioneve të qendrave të votimit, por dhe të anëtarëve të grupeve të numërimit. Diferenca që pasqyrohet këtu është..., për qartësi po e sjell me shembull. Në se për një subjekt në tabelën e rezultatit, numri i votave të vlefshme për atë ka qenë 15, në verifikimin paszgjedhor del 14. Numri 24 është njëshi në këtë rast?!

Z. E. Meta: Po, është njëshi unik! Jo në vlerë absolute!

Z. I. Celibashi: Njëshi unik, kuptoj. Kjo vlen si në rastin e votave të subjekteve, ashtu dhe për votat e vlefshme apo të pavlefshme për çdo lloj të dhëne që ka tabela e rezultatit! Në rregull! Me përjashtim të KRIIK kemi pasur të tjera sugjerime? Nga subjektet, partitë politike, apo organizata të tjera?

Z. E. Meta: Jo!

Z. I. Celibashi: Mirë, qartësisht, unë mendoj dhe në fakt nuk do të donim ta ndërmerrnim këtë si veprim. Nuk ka raste të cilat mund të konsiderohen të tilla që na bëjnë ne të mendojmë se jemi para një veprë penale dhe nuk vërtetohet kjo se dhe vetë rezultati, por dhe vlerat, sepse kjo është 24, 23 dhe është për të gjithë qendrën e votimit. Pra, nuk është një diferencë, numri 24 nuk lidhet me me një subjekt zgjedhor?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 16.05.2024*

Z. E. Meta: Jo! Psh, KZAZ-ja nr. 29 ka për tre subjekte. KZAZ-ja nr. 72 për 3 subjekte, pra flas për një qendër votimi. Qendra e votimit 4455/01 që e ka KZAZ-ja 85 bëhet fjalë për 8 subjekte. KZAZ-ja nr. 44 për 4 subjekte. KZAZ-ja nr. 36 për 5 subjekte.

Z. I. Celibashi: Po, ju keni rekomanduar që për rreth 526 qendra votimi, vetëm për 28 raste ka vend për të vendosur sanksione administrative.

Z. E. Meta: Për të propozuar se do të jetë KAS...


Z. I. Celibashi: Po pra, qoftë dhe për rekord formal të kësaj seance, kjo diferenca 24 e lart dhe maksimumi është 48, vjen në reflektim të kujt rregulli, apo principi, tipologjie?

Z. E. Meta: Referuar standartit të vendosur në verifikimin paszgjedhor të vitit 2021 si dhe referuar praktikave më të mira dhe standarteve teknike të cilat përcaktojnë.., duke qenë se nuk ka një standart të mirëfilltë teknik të përcaktimit të gabimit njerësor, por vlerësohet se marzhi i gabimit njerëzor në përpunimin e të dhënave vlerësohet të jetë nga 1 – 4 % të oportuniteteve të mundësive. Kjo është marrë si mesatare e raportit të oportuniteteve për numrin më të vogël të zgjedhësve në një qendër votimi.

Z. I. Celibashi: Këto janë tej atij marzhi, pak a shumë?

Z. E. Meta: Mesatarisht, jo detyrimisht!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 16.05.2024*

Z. I. Celibashi: Mirë atëherë,

- Miratojmë gjetjet e këtij raporti dhe ndërkohë,
- I propozojmë KAS-it, vendosjen e sanksioneve administrative për disa komisionerë dhe anëtarë të grupeve të numërimit, sipas lidhjes që do t'i bashkëlidhet këtij vendimi që në total janë 28 persona, anëtarë komisionesh, ose anëtarë të grupeve të numërimit. Mbetet në përgjegjësinë e KAS-it për të vlerësuar bazueshmërinë e kësaj kërkesë dhe eventualisht masën e sanksionit.

Vendimi nr. 48

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Durrës, me kandidatin nga lista shumemërore e subjektit “Partia Socialiste e Shqipërisë”, zj. Periana Piro Kotri”.

PJESËMARRJA :


KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- **Stafi KQZ: Znj. M. Koja, z. E. Meta, znj. P. Doçaj.**
- Parti Politike: S’ka prezent!**
- Të tjerë: KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me dy pikat e tjera të rendit të ditës, që kanë të bëjnë me plotësimin e vakancave në Bashkinë e Durrësit dhe Bashkinë e Vau-Dejës. Relatojini të dyja bashkë!

Znj. P. Doçaj: Faleminderit! Këshillat e Bashkisë: Durrës dhe Vau-Dejës, kanë njoftuar krijimin e vakancave në këshillat e tyre, nga këshilltarët e Partisë Socialiste. Në referim të nenit 164 të Kodit Zgjedhor kemi proceduar me verifikimin e kandidatëve të rradhës nga listat shumemërore të këtij subjekti zgjedhor. Pas verifikimit të formularëve të vetëdeklarimit, që është dorëzuar brenda afateve ligjore nga të dy kandidatët kemi proceduar me verifikimin e mëtejshëm nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ku të dyja këto institucione na kanë kthyer përgjigje dhe është konstatuar se të dy

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 16.05.2024*

kandidatët nuk kanë ndryshime në përbërësit e gjendjes civile dhe të dy kandidatët nuk kanë vendim penal të formës së prerë në ngarkim të tyre. Në referim të gjithë këtij verifikimi dhe në përputhje me ligjin, mendojmë se të dy kandidatët dhe të dhënat e deklaruara nga ta nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tyre në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimet për miratim.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Mirë atëherë, vendosim:

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Durrës, me kandidatin nga lista shumemërore e subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, zonjën Periana Kotri.

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vau-Dejës, me kandidatin nga lista shumemërore e subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, zonjën Majlinda Ndreca.

Çështje të tjera nuk kemi, seanca mbyllet, ditë të mbarë!

Vendimi nr. 46, 47.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

